



**Vendimi Nr. 86 /23**

**Datë: 08.09.2023**

Në bazë të nenit 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27, 34, 35, 39 dhe 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant. Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë; 28. 07. 2023 me Nr, Prot. 349/23-01/H, ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit për shitblerjen e aksioneve të ndërmarrjes Asnova Holding nga Orbico d.o.o dhe/mbi SAV 92 dhe filialeve të tij, SAVSERVIS - MOVA L.L.C., BENICE LLC., dhe PE PROMO SERVICE.

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 08.09.2023, mori këtë vendim;

## V E N D I M

**I. LEJOHET**, Përqendrimi i ndërmarrjeve ndërmjet palëve Asnova Holding dhe Orbico d.o.o, e cila do të blejë 24,9% të aksioneve dhe të drejtat të votës dhe/mbi SAV 92 dhe filialeve të tij, SAVSERVIS-MOVA LLC, BENICE LLC, dhe PE PROMO SERVICE.

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje më nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja tre mijë Euro.

## Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 28. 07. 2023 me Nr, Prot. 349/23-01/H, ka pranuar kërkesën për njoftim të përqendrimit lidhur ndërmjet palëve Asnova Holding (Shitës) dhe Orbico (Blerës) për blerjen e 24,9% të aksioneve dhe të drejtat të votës dhe/mbi SAV 92 dhe filialeve të tij, SAVSERVIS-MOVA LLC., BENICE LLC., dhe PE PROMO SERVICE, (Target)

## **Palët në Përqendrim**

**Asnova Holding**, është shoqëri aksionare private e themeluar sipas ligjeve të Ukrainës, me selinë e saj dhe adresë në Kiev rruga nr. 27 Mykola Krasnova Street, 03115, Kiev, e regjistruar në Regjistrin e Unifikuar Shtetëror të Subjekteve Juridike, me numër të biznesit 32252776. Aktivitetet kryesore janë Financimi, menaxhim dhe shërbime në fushën e teknologjisë së informacionit.

**Orbico d.o.o.**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë, me selinë e saj në Zagreb në adresën: Koturaška Cesta 69, 10000 Zagreb, Kroaci, e regjistruar në regjistrin gjyqësor me nr. 080234144. Aktiviteti i ndërmarrjes është shitje me shumicë dhe shpërndarja.

Grupi Orbico d.o.o është distributori kryesor i një numri të madh të brendev botërore të cilësisë së lartë dhe të njohura globalisht, të cilat paraqesin një asortiment të gjerë, duke filluar nga produktet e bukuri dhe kujdesit personal, produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, teknike dhe aparate elektrike, produkte farmaceutike, lodra, tekstil, cigare, si dhe produkte të vajrave motorike.

**Orbico Sh.p.k.**, është kompani me përgjegjësi të kufizuar me adresë Magjistranja Prishtinë – Shkup Graçanicë 10000 Prishtinë Kosovë, me numër unik identifikues 810501800, e angazhuar në tregjet e mallrave të konsumit me lëvizje të shpejt (FMCG) dhe tregun e bukuri, duke u fokusuar në kozmetik, parfume dhe produkte make-up të nivelit të lartë, po ashtu fokusohet në mënyre specifike në segmentin e ushqimit me një theks të dukshëm në drithërat dhe ushqimet, si dhe merre pjesë edhe në tregun jo ushqimor.

Orbico Sh.p.k është themelua në vitin 2004, si pjesë e Orbico Group që operon në 20 shtete të Evropës dhe që atëherë ka qenë kompani lider në industrinë e distribuimit në tregun e Kosovës.

**SAV 92**, është shoqëri aksionare private e organizuar sipas ligjeve të Ukrainës, me numrin identifikues të biznesit 42903398, në adresë 27 Mykoly Krasnova Street, Kiev, 03115 Ukrainë. Aktiviteti: Shitja me shumicë e mallrave jo ushqimore dhe shtëpiake.

## **Baza Ligjore**

Sipas nenit 13, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

### **Procedurat e ndjekura:**

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 23.08.2023



3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 28.08.2023

4. Me datë 09.06.2023, paletë kanë nënshkruar Marrëveshjen Kornizë për Blerjen e Aksioneve të lidhur ndërmjet ndërmarrjeve Asnova Holding dhe Orbico d.o.o, e cila do të blejë aksionet dhe të drejtat të votës dhe/mbi SAV 92 dhe filialeve të tij, SAVSERVIS-MOVA LLC,. BENICE LLC,. dhe PE PROMO SERVICE.

#### **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
- c. Parashtruesi i kërkesës dhe shitësi kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen Kornizë të lidhur me datë 9 Qershor 2023.

#### **Analiza e Konkurrencës**

Transaksioni i propozuar, ka të bëjë me blerjen e aksioneve të Asnova Holding nga Orbico d.o.o të 24.9% të aksioneve dhe të drejtave të votës në SAV 92 dhe blerjen e të drejtave që do t'i lejoje Orbicos të vendos de facto (bllokim) në vendimet që janë thelbësore për aktivitete strategjike ekonomike të SAV 92. Asnova është aksionar i vetëm i SAV 92, që së bashku me filialet drejtojnë një biznes të mallrave të konsumit me lëvizje të shpejte (FMCG) dhe biznesi i distribuimit të produktivë të bukurisë. Transaksioni do të realizohet në Ukrainë, dhe si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës. Pra, nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, edhe pse blerësi ka filiale të regjistruar në Kosovë. Transaksioni i propozuar nuk mund të forcojë asnjë pozitë dominues në treg, për më tepër transaksioni do të ndodhë jashtë Kosovës meqenëse Asnova dhe SAV 92 nuk do të operojnë në asnjë formë në Kosovë, tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

#### **Tregjet Relevante dhe Vlerësimi i Konkurrencës**

**Tregu relevant**, përcaktimi i tregu relevant mund të lihet i hapur.

**Tregu i Produktit**, tregu i biznesit, një biznes i mallërave të konsumit me lëvizje të shpejtë (FMCG) dhe tregu i produkteve të bukurisë.

**Tregu gjeografik**, do të konsiderohet tregu ndërkombëtar, kryesisht Ukraina

#### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Ukrainës. Kërkesa për Njoftim të Përqendrimit është bërë për arsye se, Orbico Grupo ka filial të regjistruar në

Kosovë që realizon të hyra përmes filialit Orbico Sh.p.k.. Transaksioni nuk do të çojë ndonjë mbivendosje horizontale në asnjë treg në Kosovë, pasi nuk ka mbivendosje konkurruese horizontale ndërmjet ndërmarrjeve, si dhe nuk ka marrëdhënie vertikale ndërmjet ndërmarrjeve. Sipas vlerësimit të përqendrimit, transaksioni nuk do të ketë efekte negative për Konkurrencën e rrjedhshme për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrebbërimit të konkurrencës në treg.

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës ka vlerësuar se, transaksioni nuk paraqet efekte negative në konkurrencë për arsye se, ky transaksion/blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominues të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

### **Shënim:**


Çdo formë e shtrebbërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës. Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

## **KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj  
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva